



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 687, datë 14.11.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2021”, i hartuar nga raportore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2021”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shumë mirë”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1. A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt

faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, por edhe gjatë gjykimit në apel, në ato çështje kur gjykata e apelit i është dërguar çështja për kompetencë, për ta shqyrtuar si juridiksionit fillestar që ajo ka, megjithëse nga kjo gjykatë nuk është shqyrtuar si e tillë¹.

Duke u nisur nga mënyra se si janë paraqitur rrethanat e çështjes në 8 vendimet e analizuara, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, gjykim penal themeli, apo kërkesë penale në fazën e ekzekutimit*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale, gjykim si shkallë e dytë mbi bazë ankimi*), faktet parashtrohen gjithmonë në pjesën e parë të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit. Edhe pse në dokumentat ligjore nuk rezulton një nën pjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes në përputhje dhe duke i integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht. Në rastet kur shkaqet e ankimit nuk i referohen përcaktimit të gabuar të rrethanave të faktit, për përcaktimin e këtij të fundit, gjyqtarja nuk ripërsërit dhe as liston provat e marra në gjykimin në shkallë të parë. Ajo i përmbahet dhe evidenton faktet e provuara në gjykimin në shkallë të parë.

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), në mënyrë të pavarur nga çka kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre dhe këtë e bën si pjesë të një procesi vlerësimi të integruar me provat e administruara gjatë gjykimit.

Në çdo dokument ligjor evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtarja tregon, për cilësim të saktë të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike.

-Identifikimi i natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja konkludon në vendim për natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile apo penale, si dhe institutin përkatës juridik (*pavërtetësi dokumenti, njohje pronar...etj*). Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të gjykatës dhe përbën edhe një nga shkaqet që gjykata ka vlerësuar në prishjen e vendimit të shkallës së parë konform nenit 467 pg 1 gërma “a” e K.Pr.Civile². Në këtë kontekst, nga vlerësimi i

¹Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

² Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë, përcaktimi i natyrës së çështjes objekt shqyrtimi, kuptohet qartësisht referuar analizës së secilit element të kërkuar nga ligji.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e pretendimeve për shkelje procedurale, konstatohet se:

Në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material:

Në vendimet civile, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil apo Kodit të Familjes:

- nenin 132, 155, 157 dhe 192 të K. Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, në lidhje me vendimin e gjykatës mbi ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, si dhe në lidhje me detyrimin për ushqim³.

Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në Kodin penal:

- nenin 287/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale⁴”;
- nenin 298/3 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve⁵”;
- nenet 333/a-1 dhe 334 të K. Penal në lidhje me organizatën kriminale dhe grupin e strukturuar kriminal⁶;
- nenin 279/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Prodhimi, mbajthja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta*⁷”;
- nenin 47 të K. Penal në lidhje me kriteret për caktimin e dënimit⁸;
- nenin 59 të K. Penal në lidhje me pezullimin e dënimit dhe vendosjen në provë⁹;

³ Vendimi nr. 397, datë 10.11.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴ Vendimi nr. 273, datë 13.12.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵ Vendimi nr. 273, datë 13.12.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁶ Vendimi nr. 273, datë 13.12.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁷ Vendimi nr. 46, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁸ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

- nenin 186 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Falsifikimi i dokumentave”¹⁰;
- nenin 248 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”¹¹.

Në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural:

Në vendimet civile, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar dispozitave procedurale të Kodit të Procedurës Civile:

- nenin 32 të K. Pr. Civile në lidhje me rastet e ngritjes së padisë¹²,
- nenin 246 të K. Pr. Civile në lidhje me fuqinë provuese të shkresave zyrtare¹³ ;
- 61 të K. Pr. Civile në lidhje me vendimin e gjykatës në rastin e konstatimit të mungesës së kompetencës¹⁴,
- nenin 466/ç dhe 467/a të K. Pr. Civile në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së apelit¹⁵

Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës penale:

- nenin 274 të K. Pr. Penale në lidhje me sekuestron preventive¹⁶;
- nenin 278 të K. Pr. Penale në lidhje me kompetencat e gjykatës së shkallës së parë gjatë hetimeve paraprake¹⁷,
- nenin 291 të K. Pr. Penale në lidhje me vendimin për mosfillimin e procedimit penal dhe nenet 329 dhe 329/a të K. Pr. Penale përkatësisht në lidhje me ankimin ndaj vendimit të prokurorisë për pushimin e akuzës/çështjes dhe kërkesën e prokurorisë për pushimin e akuzës/çështjes¹⁸;
- nenin 229 të K. Pr. Penale në lidhje me kriteret për caktimin e masës së sigurimit¹⁹,
- nenin 237 të K. Pr. Penale në lidhje me masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”²⁰,
- nenin 425 të K. Pr. Penale në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel²¹,
- nenin 279/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”²² ;
- 403-404 të K. Pr. Penale në lidhje me vendimin për gjykim të shkurtuar²³;

⁹ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁰ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹¹ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹² Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹³ Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁴ Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁵ Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁶ Vendimi nr. 273, datë 13.12.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁷ Vendimi nr. 12, datë 22.01.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁸ Vendimi nr. 12, datë 22.01.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

¹⁹ Vendimi nr. 46, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁰ Vendimi nr. 46, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

²¹ Vendimi nr. 46, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

²² Vendimi nr. 46, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

²³ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

- nenin 425 të K. Pr. Penale në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në appel²⁴.

Citimi i dispozitave procedurale penale (*neni 425 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Apel, cilësohet jo vetëm si parakusht procedural në fillimin të analizës së shkaqeve të ankimit, por shoqëron argumentimin e gjykatës edhe në rast të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, kur ankimi vjen prej tij në lidhje me masën e dënimit.²⁵

Përveç Kodit Civil apo të Familjes, gjyqtarja identifikon apo citon Kushtetutën dhe ligje organike të nevojshëm për zgjidhjen e çështjes:

- nenin 27/2 të Kushtetutës në lidhje me kufizimin e lirisë së personit si një ndër të drejtat dhe liritë themelore të njeriut²⁶ ;
- nenin 42 të Kushtetutës në lidhje me parimin e procesit të rregullt ligjor²⁷;
- nenin 29, 34 dhe 38 të ligjit nr. 133/2015 *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”* në lidhje me të drejtën e ankimit ndaj vendimit të ATP, në lidhje me afatin e përfundimit të procesit, si dhe në lidhje me efektet e hyrjes në fuqi të tij²⁸ ;
- ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”* në lidhje me të drejtën për të përfituar pension pleqërie, nenet 1 dhe 19 të ligjit nr. 4976, datë 29.06.1972 *“Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore”* (aktualisht i shfuqizuar) në lidhje me të drejtën e pensionit të anëtarit të kooperativës bujqësore, si dhe vjetërsinë në punë të vlefshme për pension²⁹;
- nenin 5, 7 dhe 8 të VKM nr. 27, datë 23.03.1968 *“Mbi statutin tip të kooperativave bujqësore”*, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të kooperativës bujqësore³⁰;
- pikat 1 deri në 9 të Vendimin e Kryesisë së Këshillit të Ministrave nr. 92, datë 04.05.1978 *“Për dokumentinin dhe kriteret e llogaritjes së vjetërsisë në punë për anëtarët e kooperativave bujqësore”*³¹.

Konflikti i normave material apo procedurale

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONE:

²⁴ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁵ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁶ Vendimi nr. 46, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁷ Vendimi nr. 12, datë 22.01.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁸ Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

²⁹ Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁰ Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³¹ Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluziviteti i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet të japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në 8 vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështje. Në çdo rast rast citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjithashtu konstatohet edhe interpretimi i normës juridike në këndvështrimin sistematik të tyre (*nenet 34, 38 të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”³²*).

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejnë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se:

Në vendimet civile analizon:

³² Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

- nenin 155 të K. Familjes në kuadër të vendimmarrjes së gjykatës në lidhje me modalitetet e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, përkatësisht në lidhje me lënien e fëmijës së mitur për rritje dhe edukim, të drejtën e takimit për prindin që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, si dhe detyrimin ushqimor të këtij të fundit. Për këtë qëllim, sillet në vëmendje dispozita konkrete dhe kushtet që derivojnë nga analiza juridike e saj³³;
- kushtet e nevojshme në gjykime me objekt vërtetimin e një fakti juridik duke identifikuar si të tilla: a) Interesi i ligjshëm që lidhet me të drejtat personale apo pasurore të pretenduesit; b) ekzistenca e një dokumenti me anë të së cilit paditësi pretendon një të drejtë të mohuar nga një palë tjetër; c) thirrja në proces e palës që heq detyrime nga njohja e vërtetësisë ose e pavërtetësisë së atij dokumenti³⁴.

Në vendimet penale analizon:

- veprën penale të falsifikimit, sa i takon formave të realizimit të saj, duke evdientuar si të tilla falsifikimin apo përdorimin e një dokumenti që dihet se është i falsifikuar³⁵;
- kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal, duke evidentuar si të tilla: a) ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm dhe të bazuar në prova se i dyshuari ka konsumuar elementet e veprës penale; b) mungesën e shkaqeve të padënueshmërisë; c) ekzistenca e rrezikut të përsëritjes së krimit, si dhe garantimin e shmangies nga procedimi³⁶ ;
- zbatimin e nenit 47 dhe 59 të K. Penal në rrethanat e çështjes objekt gjykimi³⁷.

Përpos dispozitave të Kodit Civil dhe atij Penal, gjykata interpreton edhe ligjet e posaçme relevante të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile, konkretisht në vendimet nr. 87, datë 10.03.2021 dhe në vendimin nr.318, datë 06.10.2021 të Gjykatës së Apelit Shkodër gjyqtarja ka interpretuar ligjin nr.4976, datë 29.06.1978 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore” i shfuqizuar, si dhe VKM i dalë në zbatim të tij;

- Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja përgjithësisht i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës jo vetëm përsa i përket të zgjidhjes në themel të çështjes, por edhe zgjidhjes së situatave procedurale, në rastin kur ngrihen çështje të procedurës në gjykimin në apel, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

Në vendimet civile analizon:

- lidhjen ndërmjet ngritjes së padisë sipas nenit 32 të K. Pr. Civile me realizimin e të drejtave pasurore të palës paditëse referuar rrethanave të çështjes objekt gjykimi³⁸ ;

³³ Vendimi nr. 397, datë 10.11.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁴ Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁵ Vendimi nr. 12, datë 22.01.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁶ Vendimi nr. 46, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁷ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

- legjitimitimin aktiv dhe pasiv në padinë objekt gjykimi³⁹ ;
- Në çështjen civile, të përfunduar me vendimin nr.195, datë 27.10.2021, të cilës gjykatës së apelit i është dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, në bazë të vendimit për shpalljen e moskompetencës lëndore, e cila ka vlerësuar se Gjykata e Apelit ka kompetencën lëndore për gjykimin e saj, si juridision fillestar, gjyqtarja analizon dispozitat e ligjit nr.133/2015“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës, duke referuar në mbështetje të argumentit të saj edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë në vendimin njësuës nr.611, datë 07.02.2018. Nga përmbajtja e vendimit por edhe e dosjes gjyqësore, duket se gjykata në këtë rast ka marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur në gjykim në apel (në seancë gjyqësore) nga njëra prej palëve pjesmarrëse (avokatura e shtetit, për shpalljen e moskompetencës lëndore të saj), duke vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë, pasi ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk është kompetente për shqyrtimin e saj. Pra gjykata e apelit në këtë rast ka vendosur prishjen e një vendimi, që nuk i ka shkuar në bazë të ankimit, por në bazë të vendimit të shkallës së parë që ka vlerësuar se gjykata e apelit është kompetente për shqyrtimin e saj si juridiksion fillestar, në referim të ligjit nr.133/2015. Në vendim, gjyqtarja ka cituar nenin 61 të KPRC, që në fakt referon dhe rregullon rastet kur gjykata kryesisht ose me kërkesë të palëve konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e një çështje, vendos moskompetencën e saj, por nuk ka bërë një interpretim të kësaj dispozite edhe në raport me dispozitat e tjera vijuese, konkretisht të nenit 62 dhe 64 të KPRC, në të cilat përcaktohet se gjykata të cilët i dërgohet çështja për kompetencë, e pranon atë për shqyrtim dhe se konflikti i kompetencës nuk lejohet por gjykata që i është dërguar çështja parashtron qëndrimin e saj në Gjykatën e Lartë. Neni 64 i KPRC përcakton Gjykatën e Lartë, si gjykatë kompetente që rregullon kompetencën midis gjykatave, në rast se gjykata që i dërgohet çështja për kompetencë vlerëson se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, i parashtron qëndrimin e saj gjykatës së lartë. Gjyqtarja në këtë rast ka vendosur prishjen e çështjes dhe kthimin e saj për rigjykim në referim të gërmës nenit 466m gërma « ç», që referon tek neni 467, gërma « a» të K.Pr.Civile, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën në gjykimin e çështjes, por pa bërë një interpretim të këtyre dy dispozitivave. Neni 467 i KPRC, gërma « a» përcakton rastet kur gjykata e apelit disponon me prishjen e një vendimi të shkallës së parë dhe kthimin e saj për rigjykim, që i ka shkuar gjykatës së apelit në bazë të ankimit të palës, kur gjykata e shkallës së parë ka dhënë një vendim përfundimtar në shkelje të dispozitave mbi juridiksionin dhe kompetencën. Por edhe në këtë rast, kjo dispozitë duhet të interpretohet në raport me nenin 467/b të Kodit të Procedurës Civile, që përcakton se kur gjykata konstaton se vendimi është i drejtë dhe është dhënë brenda kompetencave të gjykatës që i takonte çështja, gjykata e apelit nuk e prish çështjen por mjaftohet me vënien në duke të gjykatës që ka dhënë vendimin për parregullsinë e vendimit të saj.

Në vendimet penale analizon:

³⁸ Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 dhe Vendimi nr. 87, datë 10.03.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

³⁹ Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 dhe Vendimi nr. 87, datë 10.03.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

- nenin 274 të K. Pr. Penale në lidhje me sekuestron preventive. Në këtë kuadër, kujdeset të analizojë qëllimin e këtij parashikimi ligjor, si dhe rastet e aplikimit të tij, duke evidentuar përkatësisht: *a)* kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi, që lidhet me veprën penale mund të rëndojë apo zgjatë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale; *b)* dhe/ose për sendet produkt të veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të K. Penal⁴⁰; gjithashtu analizon zbatueshmërinë e nenit 274 të K. Pr. Penale në rrethanat konkrete të çështjes⁴¹;
 - dispozitat ligjore të zbatueshme në kuadër të kontrollit gjyqësor të veprimtarisë së prokurorisë e përkatësisht nenet 278, 291 dhe 329 të K. Pr. Penale, duke theksuar se ky kontroll ushtrohet në bazë të parimit të ligjshmërisë dhe garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të⁴²;
 - kriteret për caktimin e masës së sigurimit “*Arrest në shtëpi*” referuar nenit 229 të K. Pr. Penale, duke vendosur theksin tek raporti mes rëndësisë së faktit dhe sanksionit të parashikuar me masën e dënimit që mund të caktohet si dhe zbatimin e këtij neni mbi faktet objekt gjykimi⁴³ ;
 - nenin 425 të K. Pr. Penale në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel. Në këtë kuadër, analizon se cilësimi juridik i veprës penale është një element me rëndësi i procesit penal që lidhet me zbatimin korrekt të ligjit material penal, e rrjedhimisht kualifikimi i ligjor i drejtë i faktit penal të atribuar të pandehurit, mund dhe duhet të shqyrtohet nga gjykata e apelit, edhe kryesisht, pavarësisht shkaqeve të ankimit⁴⁴
- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.***

Në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me :

- me parimin e ndalimit të dënimit dy herë për të njëjtin fakt përmend jurisprudencën e GjEDNJ, përkatësisht çështjen Boman kundër Finlandës⁴⁵;
- me kushtet e nevojshme për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventiv referon jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 201, datë 09.12.2015 të Kolegjit Penal⁴⁶;
- me kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes penale referon jurisprudencën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 2, datë 20.06.2013⁴⁷;
- me kuptimin dhe qëllimin e dënimit me burgim dhe me gjobë, si dhe aplikimin përkatës në varësi të nevojës së ndëshkimit referon vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese⁴⁸;

⁴⁰ Vendimi nr. 273, datë 13.12.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴¹ Po aty.

⁴² Vendimi nr. 12, datë 22.01.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴³ Vendimi nr. 46, datë 25.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁴ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁵ Vendimi nr. 273, datë 13.12.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁶ Vendimi nr. 273, datë 13.12.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁷ Vendimi nr. 12, datë 22.01.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁴⁸ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

- me kompetencën lëndore të gjykatës në zbatim të ligjit nr. 133/2015 referon vendimin njësuës të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 611, datë 07.02.2018⁴⁹.

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur. Në mënyrë më specifike:

- Citon dhe aplikon parimin e interesit më të lartë të fëmijës⁵⁰ ç ;
Citon parimin e ligjshmërisë⁵¹.

Gjyqtarja e vlerëson këtë kriter në shkallë shumë të lartë, ku shprehet: *“Në vendimet gjyqësore jo vetëm që kam përcaktuar qartë dhe saktë dispozitat e ligjit të zbatueshëm por edhe kam interpretuar këto dispozita në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke u shprehur sa më qartë dhe thjeshtë. Aty ku ka qenë e duhur dhe në funksion të arsytimit të vendimit, kam bërë pjesë të vendimeve të mia, praktikave të Gjykatës së Lartë, kryesisht vendimet unifikuese dhe njësuës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese si edhe të GJEDNJ”.*

Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzimin maksimal, duke pretenduar se është vetëm një vendim i saj, dhe se për këtë çështje ka qendrim të ndryshme në rradhët e gjyqtarëve të apelit. Aftësia e saj shumë e lartë në interpretimin e ligjit material dhe procedural konstatohet lehtësisht në vendimet e tjera burim vlerësimi.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësorë unifikuese, praktikën gjyqësorë të Gjykatës së Lartë, dhe të GJEDNJ, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Megjithëse nuk konstatohet e njëjta shkallë kujdesi i gjyqtarës në një vendim gjyqësor, në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale që lidhen me përcaktimin e gjykatës kompetente që rregullon kompetencën midis gjykatave të ndryshme, si dhe disponimet e gjykatës në rastet kur çështja i është dërguar asaj nga një gjykatë tjetër, që ka vlerësuar se çështja/ mosmarrëveshja është në kompetencë lëndore të gjykatës së apelit si juridiksion fillestar, duke qenë se ka praktika të ndryshme lidhur me këtë çështje dhe nuk ka një praktikë të unifikuar apo njësuës nga Gjykata e Lartë, Këshilli vlerësoi se një vendim i tillë nuk ndikon në vlerësimin e aftësisë së gjyqtarët në lidhje me interpretimin e dispozitave

⁴⁹ Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵⁰ Vendimi nr. 273, datë 13.12.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵¹ Vendimi nr.12, datë 22.01.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

procedurale. Ndërkohë, rezulton se dispozitat e ligjit material janë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke e pasuruar interpretimin ligjor edhe me referimin në praktikën relevante të Gjykatës së Lartë apo GJEDNJ.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “mbi mesatare” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Gjyqtarja, përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, apo përdorimi i fjalëve fyese apo denigruese. Përdor përgjithësisht të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (edhe të shkronjave “ç” dhe “ë”). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine⁵², por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Vendimi përgjithësisht është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe në disa raste edhe duke e numërtuar.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit

⁵² Vetëm në raste shumë të rralla, psh në vendimin nr. 30, datë 11.02.2021 *lura novit curia*”.

Gjyqtarja e vlerëson këtë kriter në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsytimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, mndësojnë leximi të organizuar që ofron kalim nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra në mënyrë logjike, ku dalin qartë dhe konkluzionet e gjykatës, të cilat vijnë si rrjedhë llogjike e të gjithë arsytimit në tërësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja ka një metodologji të saj të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të së cilit i duhet të citojë edhe vendimmarrjen objekt ankimi si dhe shkaqet e ankimit

të palëve. Pjesa përshkuese e vendimit është e ndarë me paragrafë, të cilat vijnë në rrjedhë kronologjike dhe logjike midis njëri-tjetrit, megjithëse nuk i ndanë vendimet në nënpjesë me fjali përshkuese, nga përbajtja e tyre identifikohet qartë secila pjesë vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, objekti dhe baza ligjore, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, subjekti ankues dhe shkaqet e ankimit, si dhe kërkimet përfundimtare.

Në pjesën përshkuese - arsyetuese gjen pasqyrim fillimisht vlerësimi i gjykatës për vendimin ndaj të cilit është paraqitur ankimi dhe më pas vijohet me: faktet e çështjes; bazën ligjore të aplikueshme dhe analizën juridike të saj; analizën e pretendimeve të ankuesit. Kjo pjesë është e ndarë në disa nën-pjesë (edhe pse jo me tituj të përcaktuar si p.sh. rrethanat e faktit, ligji i zbatueshëm, analiza juridike, nga mënyra e pasqyrimin të tyre në vendim konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nëndarje) në të cilën në mënyrë të detajuar analizohen: rrethanat e fakteve të çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi apo siç kanë rezultuar nga hetimi i bërë në shkallë të parë, rrethanat procedurale të gjykimit në apel dhe vlerësimi i gjykatës së apelit mbi shkaqet e ankimit, në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile apo nenit 428 të K.Pr.Penale, të drejtën e palës për të paraqitur rekurs, afatin e paraqites së rekursit, si dhe momentin kur fillon të llogariten ky afat., si dhe data e shpalljes së vendimit.

Karakteristikë e gjyqtarës është vlerësimi që në fillim i vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, duke vazhduar më pas me analizimin e konkluzionit. Gjithashtu ajo i jep përgjigje të gjitha pretendimeve të palës të parashtruar në ankim, duke i marrë me radhe e duke numërtuar analizën ligjore të bërë.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe nenit 466 të K.Pr.Civile dhe vendimet penale elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale. Po kështu vendimet janë të strukturuar në paragrafë me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur në ankim, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Gjyqtarja ndjek rregullat të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë kriter në shkallë shumë të lartë.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin e përmbajtjes, por jo atë vizual, por duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij, megjithëse jo gjithmonë e dallueshme më aspektin vizual.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përse u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar⁵³.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha dokumentet ligjorë të analizuar rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

⁵³ Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.

Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithmonë merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruar në ankim nga pala ankuese, gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse të parashtruara gjatë gjykimit në shkallë të parë.

Kështu, sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, shkaqeve të ankimit, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi, (*me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo civil etj.*) apo janë pjesë e analizës ligjore, duke u identifikuar në mënyrë të veçantë në fund të pjesës arsyetuese. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsyetimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçantë të arsyetimit (por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret), pretendimet e palëve të cilat lidhen me shkaqet e ankimit gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

Në të gjitha vendimet evidentohen edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të shprehur, ngritja e çështjeve për diskutim, duke ardhur e nënkuptuar nga analiza dhe arritja e përfundimit ligjor. Konstatohet identifikimi i tekstit normativ (penal apo civil) kur është e nevojshme pa shkuar në përsëritje, duke cituar jo vetëm nenin përkatës por edhe atë që sanksionon ai, në funksion të analizimit të elementeve të figurës së veprës penale, të përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike civile, elementëve përbërës të tij si dhe analizimin e saj në raport me faktet konkrete.

Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, përveç analizës së provave dhe nxjerrjes së faktit juridik konkret, referuar shkaqeve të ankimit, gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme psh: (i) Institutit të martesës duke u ndaluar tek zgjidhja e martesës dhe rregullimi i pasojave që rrjedhin prej saj. Kështu, duke theksuar parimin e interesit më të lartë të të miturit, si dhe duke mbajtur në konsideratë shkaqet e ankimit, ndalet në analizën e tre modaliteteve të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, përkatësisht: lënien e fëmijës për rritje dhe edukim; të drejtën e takimit për prindin që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim; si dhe detyrimin për ushqim⁵⁴; (ii) Institutit juridik të pushimin e procedimit penal gjatë fazës së hetimeve paraprake duke theksuar se ky kontroll ushrohet në bazë të parimit të ligjshmërisë, garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të, në përputhje me standardet e vendosura nga neni 42 i Kushtetutës, referuar edhe në jurisprudencën unifikuese (vendimi nr. 2, datë 20.06.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)⁵⁵; (iii) Institutit të njohjes së vjetërsisë në punë, e lidhur kjo me të drejtën pasurore për pension. Analizohet legjitimiteti aktiv dhe pasiv, gjithashtu është mbajtur në konsideratë legjislacioni i kohës kur pala ka qenë në marrëdhënie pune.⁵⁶

⁵⁴Vendimi nr. 397, datë 10.11.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵⁵Vendimi nr. 12, datë 22.01.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁵⁶Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 dhe Vendimi nr. 87, datë 10.03.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

Në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur nga ana e gjyqtarës në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, i kushtohet rëndësi e veçantë marrëdhënies shkak – pasojë si në marrëdhëniet juridike civile ashtu dhe në çështjet penale.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë kriter në shkallë shumë të lartë duke u shprehur: *“Në të gjitha vendimet gjyqësore kam analizuar në mënyrë të qartë dhe konçize konceptet juridike, institutet e të drejtës, duke i trajtuar këto të fundit si duke iu referuar doktrinës ashtu edhe praktikës ligjore unifikuese (aty ku ka patur të tillë). Çdo pretendimi të palëve u jepet përgjigje në vendime, duke analizuar secilën prej shkaqeve të ankimit në raport me vendimmarrjen e shkallës së parë dhe provave të marra në gjykim, që lidhen me pretendimet e palës ankuese ndaj vendimit të shkallës së parë, në raport edhe me pretendimet e palës kundërshtare në kundër-ankim, duke iu përmbajtur kufijve të shkaqeve që janë paraqitur në ankim.*

Në asnjë prej vendimeve, dispozitat ligjore, nuk citohen në mënyrë formale dhe thjesht për të shtuar volumin e arsyetimit të vendimit, pa u shoqëruar më pas me analizën e zbatimit të tyre në rastin konkret”

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin : fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse që përbëjnë shkaqe ankimi apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimit për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit
KRITERI
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

1. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 1588 çështje për të cilat ligji parashikon afat shqyrtimi (ligjor ose orientues), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “ Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “ Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe “Penale seancë parapake”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 149 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, 18 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 131 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (18 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (149 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar **12 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja parashtron, ndër të tjera, “...Në lidhje me këtë kriter vlerësimi çmoj të evidentoj faktin se, si gjyqtare apeli, dhe veçanërisht si relatore e çështjeve, në këtë periudhë pune jam përballur me një numër të lartë të dosjeve të ardhura për gjykim, me një numër të lartë dosjesh që presin radhën e gjykimit të mbartura nga gjyqtarët e pezulluar nga Vetingu i KPK (një gjyqtar në vitin 2018, dy gjyqtarë në vitin 2019 dhe tre gjyqtarë në vitin 2020) të cilat janë rishortuar mes gjyqtarëve të mbetur, me një numër të lartë çështjesh që kanë afate të ngutshme ligjore gjykimi, me një numër të lartë të kërkesave për përshpejtimin e çështjeve (kryesisht çështje civile me objekt “njohjen e viteve të punës me qëllim përfitimin e të drejtës së pensionit”, “zgjidhje martese”, “zgjidhje e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga marrëdhënie pune”), nisur dhe nga numri i reduktuar i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shkodër për shkak vetingu (ku probabiliteti i numrit të dosjeve të reja për gjykim është më i lartë), ka krijuar një ngarkesë të paparashikueshme, në

kalendarin tim të seancave gjyqësore. Pavarësisht kësaj, nga ana ime është bërë përpjekje maksimale për të arritur në respektimin e afateve ligjor të përfundimit të gjykimit të çështjeve të ndryshme gjyqësore, brenda këtyre afateve. Referuar statistikave, evidentohet ngarkesa në punë, dhe përpjeket maksimale që unë kam realizuar për të respektuar afatet si ligjore ashtu edhe ato standard...’’

Në përlogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, përlogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarës), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët apo 35 ditë kalendarike) ;
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve 6 ditë ;

Po ashtu, gjyqtarja ka shpjeguar lidhur me kohëzgjatjen e disa çështjeve, të cilat, referuar tabelave me të dhëna statistikore, në raport me shpjegime e saj, rezulton si vijon:

- (i) në tabelën nr. 1, çështja me nr. rendor 69 me objekt *“Kundërshtim i veprimeve përmbartimore”*⁵⁷, është shortuar më datë 15.06.2021 dhe ka përfunduar me datë 25.06.2021, për 10 ditë, **pra brenda afatit të parashikuar nga ligji**⁵⁸.
- (ii) në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 46 me objekt *“Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal”*, është shortuar më datë 08.09.2021 dhe ka përfunduar me datë 24.09.2021, për 16 ditë, **pra brenda afatit 30 ditor të parashikuar nga ligji**⁵⁹.
- (iii) në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 1, 2 dhe 13 me objekt *“Pushim i çështjes”*⁶⁰, janë shortuar më datë 30.12.2020 (çështje 1 dhe 2) dhe kanë përfunduar me datë 22.01.2021, shortuar më datë 17.05.2021 dhe ka përfunduar me datë 02.06.2021, janë gjykuar për 23 ditë, 23 ditë dhe 16 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e dy çështjeve me nr. rendor 1 dhe 2 kohën e festave të fundvitit dhe mbarjen e dosjeve, rezulton që çështjet janë gjykuar për 17 ditë, 17 ditë dhe 16. Tejkalimi prej 1-2 dite i njëres çështje do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë do të **konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 15 ditor**.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore si dhe çështjeve të analizuar më sipër, rezultoi se numri i çështjeve me afat ligjor është 149 çështje. Po ashtu në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (18 çështje), duhet të zbriten 5 çështje, pasi referuar analizës për secilën prej tyre, rezultoi se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor. Në këtë mënyrë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (13 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji

⁵⁷ neni 610 i K. Pr. Civile ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë në rastin e shqyrtimit në dhomë këshillimi dhe 45 ditë në rastin e shqyrtimit në seancë gjyqësore.

⁵⁸ Si afatit 30 ditor ashtu edhe afatit 45 ditor duke qenë se nuk kemi informacion nëse është shqyrtuar në dhomë këshillimi apo seancë gjyqësore.

⁵⁹ neni 291 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë

⁶⁰ Neni 329/3 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 15 ditë : Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve.

parashikon afat gjykimi (149 çështje), rezulton të jetë 8.7 %, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 15 pikë.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë kriter në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkalar me një kohë relativisht të shkurtër (*1 deri në 2 ditë*), atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 13 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (13 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (149 çështje), rezulton të jetë **8.7 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor**, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është brenda marzhit “0-10 %”.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 320 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Penale kundërvajtje”, “Kërkesa penale faza e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë” dhe “Juridiksion fillestar” për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e apelit , si vijon:

- jo më tej se 6 muaj (180 ditë) për gjykimet civile;
- jo më tej se 6 muaj (180 ditë) për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 9 muaj (270 ditë) për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 320 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 13 prej tyre ose **4 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor në fuqi.**

Në formularin e integruar të vlerësimit, referuar këtij treguesi, gjyqtarja, ndër të tjera shprehet “Edhe në lidhje me këtë tregues, çmoj të analizoj jo vetëm të dhënat statistikore të vëna në dispozicion nga administrata e Gjykatës së Apelit, Shkodër të cilat janë siguruar nga sistemi ICMIS dhe nga regjistrat referues të çështjeve që regjistrohen në Apel por edhe të dhëna të cilat nuk dalin nga ky sistem dhe që mund të evidentohen në mënyrë të detajuar nga ana ime si gjyqtare e çështjeve.

Në lidhje me këtë kriter vlerësimi çmoj të evidentoj faktin se, pavarësisht ngarkesës së paparashikueshme dhe numrit të lartë të dosjeve për gjykim, nga ana ime është bërë përpjekje maksimale për të arritur në respektimin e afateve ligjor në lidhje me marrjen e vendimit pa tejkuluar qoftë dhe standardin minimal kohor. Por pavarësisht kësaj, në lidhje me sasinë e këtyre çështjeve, çmoj të bëj një analizë të pavarur në raport me shkakun e kalimit të afatit minimal kohor.

Për disa prej tyre çmoj të jap shpjegimet e mia, në mënyrë të veçantë:

a. Konkretisht në lidhje me çështjet civile me objekt “Kundërshtim vendimi të ATP”, për nga natyra e çështjes, gjykimi i tyre është kompleks, përsa i përket provave të marra, duke përfshirë përveç provave shkresore dhe me dëshmitarë, edhe prova me ekspert topograf, ku në rastin e marrjes së kësaj prove, K.Pr.Civile ka parashikuar një procedurë më të gjatë, që përfshin njohjen e palëve, lënien afat për paraqitjen e aktit dhe lënien afat palëve për t’u njohur me të dhe për të paraqitur pretendime. Një gjë e tillë sjell si pasojë një numër më të madh seancash në raport me çështjet e tjera;

b. Shpesh kërkohen prova nga institucionet që nuk janë palë në proces, të cilët jo gjithmonë përgjigjen brenda afatit të caktuar nga gjykata;

c. Rastet e çështjeve kur lind e nevojshme të kërkohet ndihma e Zyrës së Përgjithshme të Gjendjes Civile (për të saktësuar adresën e të paditurit ose personave të tretë) apo e Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, për të verifikuar nëse personi që thirret është brenda apo jashtë Shqipërisë;

d. Në gjykime shpesh herë ka shumë palë ndërgjyqëse, njoftimi i të cilëve sjell vështirësi dhe shpesh aplikohet edhe njoftimi me shpallje konform nenit 133 të K.Pr.Civile;

e. Në marrjen e provës me ekspert kemi shpesh zvarritje të gjyqimit për shkak se ekspertët kanë një axhendë të ngjeshur pasi punojnë edhe në rrethe të tjera gjyqësore, me distancë gjeografike të largët me Shkodrën (duke marrë në konsideratë dhe licencimin e tyre);

f. Përfaqësuesit e palëve, për shkak të numrit të madh të çështjeve që marrin përsipër të mbrojnë, kanë mbivendosje të seancave gjyqësore dhe paraqesin kërkesa për shtyrje të seancave gjyqësore, duke mos u siguruar mbrojtje ligjore palëve që përfaqësojnë;

g. Gjithashtu në afatin e përgjithshëm të gjyqimit, duhet të merret parasysh periudha e pushimeve prej 25 ditë pune dhe mbartja dhe riregjistrimi manual i dosjeve, në kryesekretari, gjatë 2 javëve të para të muajit janar të çdo viti;

h. Meqënëse ka shpesh shumë palë ndërgjyqëse, lind e nevojshme që të bëhet kalimi procedural në rast vdekjeje të palës dhe mbarimit të personit juridik, që sjell vështirësi për gjykimin dhe zgjatje të afateve. Në shumicën e rasteve meqënëse palët që kërkojnë lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, pranë noterit, nuk janë trashëgimtarë të palës, kjo sjell si pasojë që noteri të refuzojë kërkesën, duke sjellë zvarritje të gjyqimit”.

Në përlogaritjen e standardit minimal kohor, për të gjitha dosjet, përlogaritja e afateve do të fillojë nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Në të gjitha dosjet, në përlogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune apo 5 javë kalenderike për gjyqtarët);
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve 6 ditë ;

Gjyqtarja ka pretenduar që për disa çështje të mbahën parasysh shkaqet e tejkalimit. Duke mbajtur në konsideratë analizën e sipërcituar mbi pretendimet e parashtruara nga ana e gjyqtarës, vlerësohet që të konsiderohen si çështje të cilat kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor çështjet si më poshtë:

- (i) Në tabelën nr. 12 tek kategoria e çështjeve “*në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë*”, çështjet me nr. rendor 11 dhe 20 janë gjykuar për 64 dhe 66 ditë. Tejkalimi i afatit me 4 dhe 6 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (ii) Në tabelën nr. 14 tek kategoria e çështjeve “*gjykim fillestar*”, çështja me nr. rendor 2 është gjykuar për 185 ditë. Tejkalimi i afatit me 5 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështja do të konsiderohet e gjykuar ***brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***

Pra, janë gjithsej 3 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do t'i zbriten numrit prej 13 çështjesh të përlogaritura në raportin analitik, duke mbetur kështu 10 çështje.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (10 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat parashikohet standardi minimal kohor (320 çështje), pa përfshirë çështjet për të cilat në ligj parashikohen afate gjykim, gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 3.1 % të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor. Sipas “*Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit*”, të miratuar me vendimin me Nr. 264, datë 21.11.2019 të KLGJ, përqindja matematikore prej 3.1 % përkon me nivelin e vlerësimit 5 (pesë) pikë (0-10% - 5 pikë).

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e vlerësojnë këtë kriter në shkallë shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të lartë për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, përjashtohen çështjet ku standardi është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (*deri në*

7 ditë), atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 10 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (10 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat parashikohet standardi minimal kohor (320 çështje), rezulton të jetë 3.1% e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve që rezulton të jetë 3.1 %, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është 3.1% “0-10 %” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është si më poshtë:

- i.* Në çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 54 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
- ii.* Në çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 22 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej katër muajsh.
- iii.* Në çështjet e kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 44 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
- iv.* Në çështjet e kategorisë “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare rezulton të jetë 34 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
- v.* Në çështjet e kategorisë “*krime*”, koha mesatare rezulton të jetë 60,5 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë dhe nëntë muajsh.
- vi.* Në çështjet e kategorisë “*kundravajtje*”, koha mesatare rezulton të jetë 41 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- vii.* Në çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezulton të jetë 40 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- viii.* Në çështjet e kategorisë “*juridiksion fillestar-themel*”, koha mesatare rezulton të jetë 154 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
- ix.* Në çështjet e kategorisë “*juridiksion fillestar-kërkesa*”, koha mesatare rezulton të jetë 12 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e vlerësojnë këtë kriter në shkallë shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2021-31.12.2021) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (469 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (479 çështje) brenda periudhës 1 vjeçare të vlerësimit, **është 98 %** përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 8 pikë, duke qenë se rezulton 93-99%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Për aspektin sasior sipas pikës 3, gërma “h” të vendimit të ish KLD-së, nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” gjyqtari i Gjykatës së Apelit që është organizuar në dhomë penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 çështjesh penale (krime e kundërvajtje), i llogaritur në periudhën 3 vjeçare jo me pak se 450 çështje penale dhe gjyqtari i dhomës civile, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 çështje civile në vit, i llogaritur në periudhë 3 vjeçare, jo më pak se 600 çështje. Aneksi 1 i

Sistemit të vlerësimit, në aspektin sasior nuk jep standarde minimale për gjyqtarin e gjykatës së apelit që nuk është organizuar në seksione. Në këto kushte, për analogji, edhe me standardet minimale të përcaktuara për gjyqtarin e shkallës së parë që nuk është organizuar në seksione, sipas përcaktimeve të Aneksit 1, do të merret si standard minimal 200 çështje themeli në vit (penale dhe civile).

Në lidhje me respektimin nga ana e gjyqtarës {...} të standardit sasior në fuqi, rezulton se gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2021-31.12.2021, ka gjykuar 469 çështje nga të cilat 301 çështje janë me palë kundërshtare, duke e tejkaluar standardin minimal, me 101 çështje ose me rreth 50.5 %.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 98 %, por ndërkohë rezulton se ajo ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara me mbi 50 %, vlerësohet se, në analizë logjike të të dhënave statistikore, duke marrë në konsideratë përqindjen e çështjeve të shqyrtuar tej standardit minimal sasior dhe ngarkesën totale në punë, gjyqtarja duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që përkon me rendimentin në masën 98 %, duke u pikëzuar me 10 pikë, pasi gjyqtarja e ka tejkaluar standardin sasior me 50 %.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- i.* Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 69 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
- ii.* Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 44 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
- iii.* Për çështje të kategorisë “familjare me palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 54 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
- iv.* Për çështje të kategorisë “marrëdhënie pune” koha mesatare e arsytimit është 59,5 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

- v. Për çështje të kategorisë “*krime*” koha mesatare e arsyetimit është 54 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.
- vi. Për çështje të kategorisë “*kundravajtje*” koha mesatare e arsyetimit është 56,5 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.
- vii. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”:
 - me objekt sipas nenit 228, 248, 260 dhe 261 të K. Pr. Penale, koha mesatare e arsyetimit është 16 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 249 i K. Pr. Penale.
 - për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 43 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.
- viii. Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 55 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.
- ix. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit koha mesatare e arsyetimit është 46 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale.
- x. Për çështje të kategorisë “*juridiksion fillestar*”:
 - me objekt “*shuarje mase sigurimi sipas nenit 261 të K. Pr. Penale*” koha mesatare e arsyetimit është 12 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 249 i K. Pr. Penale.
 - për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 34 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Pra rezulton se afati i arsyetimit të vendimit është më i gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Referuar Metodologjisë, kur koha e arsyetimit është më i gjatë se afati procedural për të gjithë kategoritë e çështjeve, i korespondon pikëzimit me 3 pikë.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e vlerësojnë këtë kriter në shkallë mbi mesatre. Në formularin e vetëvlerësimit ndër të tjera gjyqtarja shprehet: “... *Ligji procedural civil nuk parashikon ndonjë afat konkret në lidhje me dorëzimin e vendimit të arsyetuar të gjykatës së apelit. Edhe me ndryshimet që i janë bërë K.Pr.Civile, përsëri nuk parashikohet ndonjë afat konkret për dorëzimin e vendimit të arsyetuar të gjykatës së apelit (ndryshe nga sa është parashikuar për vendimin e arsyetuar në gjykimin penal), por ligjvënësi ka përcaktuar për dorëzimin e vendimit nga gjykata e shkallës së parë një afat prej 20 ditësh. Ndërkohë, është parashikuar se afati i ankimit fillon nga momenti i dorëzimit të vendimit të arsyetuar palëve (neni 444 i K.Pr.Civile). Por këtu dua të evidentoj faktin se, në disa raste, koha e përfundimit të arsyetimit të vendimit, jo gjithmonë korrespondon me momentin e dorëzimit të dosjes në kryesekretari pasi nuk është e mundur që të bëhet vetëm dorëzimi i vendimit përfundimtar paraprakisht.*

Në shumicën e rasteve, dosjet janë voluminoze, për shkak se janë administruar shumë prova shkresore ose edhe çështjet janë kthyer për rigjykim, dhe një gjë e tillë sjell vonesa në dorëzimin e tyre në sekretari, gjë që nuk varet nga mënyra e menaxhimit të kohës nga ana e gjyqtarit por e administratës së gjykatës. Gjatë orarit zyrtar zhvillojmë një numër të konsiderueshëm seancash gjyqësore dhe një gjë e tillë sjell vështirësi edhe për sekretaren gjyqësore në administrimin dhe dorëzimin e dosjes, me vendim përfundimtar, në sekretari...”.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave burim vlerësimi bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë, volumin e çështjeve ku rezultoi se për një periudhë 1 vjeçare (01.01.2021-31.12.2021), gjyqtarja ka dhënë 469 vendime, pra rreth 42.6 vendime në muaj, apo mesatarisht 1.9 vendime në ditë, referuar ditëve mesatare të punës në një muaj prej 22 ditësh, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, konkretisht kohën e angazhimit të gjyqtarës në gjykimet si anëtare e trupit gjykues, nga ana e relatores u propozua që për këtë tregues gjyqtarja të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi, duke e pikëzuar me 6 pikë, kjo duke pasur parasysh se vlerësuesi nuk mund të vlerësojë aftësinë e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues tej rritjes së pikëzimit me vetëm 1 shkallë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja paraqiti kundërshtime dhe kërkoi një vlerësim më të lartë, duke pretenduar se shkaqet që kanë çuar në arsyetimin e vendimeve tej afatit lidhet me ngarkesën tepër të lartë të në punë, ku ajo gjatë një viti ka dhënë 469 vendime vetëm si relatore, por ka shfaqur kujdes të njëjtë edhe në çështjet ku ka qenë si anëtare e trupit gjykues lidhur me arsyetimin e vendimeve.

Në Kodin e Procedurës Penale, neni 382 të tij parashikohet se;” 1. Pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

2. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

3. Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

4. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.”

Gjithashtu në nenin 430/1 pika 4 dhe 5 të K.Pr. Penale, parashikohet se;” Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të

zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

5. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikës 4, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përlegjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.”

Në interpretim të këtyre dispozitave, rezultojnë se afati i arsyetimit të vendimeve në apel për çështjet penale është 30 ditë, ndërsa për çështjet që gjykohen nga Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ky afat mund të zgjatet edhe për një periudhë tjetër me rreth 30 ditë, pra duke shkuar me 60 ditë për shkak të natyrës së vështirë të çështjeve që gjykon kjo gjykatë. Ndërsa në pikën 5 të nenit 430/1 të KPRP, është parashikuar se afati 30 ditorë mund të zgjatet në raste përjashtimore, por në këtë rast duhet të njoftohet kryetari i gjykatës.

Në formularin e integruar të vetvlerësimit, kryetari i gjykatës e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtarës për këtë tregues “mbi mesatare”, duke u shprehur se:” *Përsa i takon këtij treguesi, mendoj se gjyqtarja {...} ka treguar që mund të menaxhojë jo vetëm ngarkesën e lartë në detyrë, dhënien e drejtësisë pa vonesa, por i ka kushtuar një vemendje të veçantë edhe arsyetimit dhe zbardhjes në kohë të vendimeve, duke u dhënë në këtë mënyrë palëve mundësinë të kuptojnë arsyet e vendimarrjeve apo edhe për tu ushtruar mjetet e tjera të ankimit si rekursi. Këtë fakt e tregon edhe analiza statistikore e të dhënave të këtyre viteve, ku të gjitha vendimet janë arsyetuar brenda afateve ligjore”.*

Pasur parasysh ngarkesën tepër të lartë të përballuar nga gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2021, ku rezultoi se ajo gjatë periudhës së vlerësimit ka dhënë 469 vendime, angazhimin e saj në si anëtare e trupit gjykues në gjykime të zhvilluara në Gjykatën e Apelit Shkodër, por edhe si e deleguar në gjykatat e tjera të apelit gjatë periudhës së vlerësimit 2021, të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vlerësohet se një situatë e tillë përbën rast përjashtimor që çon në zgjatjen e afatit të arsyetimit të vendimit. Për sa kohë se nuk ka një afat maksimal deri kur mund të zgjatet ky afat, vlerësojmë të përdorim si analogji afatin 60 ditorë të përcaktuar për arsyetimin e vendimeve në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si dhe në Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Nga analiza e të dhënave statistikore, rezultoi se ;

- I. Për çështje të kategorisë “*krime*” koha mesatare e arsyetimit është 54 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale, por më e shkurtër se afati prej 60 ditësh.
- II. Për çështje të kategorisë “*kundravajtje*” koha mesatare e arsyetimit është 56,5 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale, pra më e shkurtër se afati 60 ditorë.
- III. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”:
 - me objekt sipas nenit 228, 248, 260 dhe 261 të K. Pr. Penale, koha mesatare e arsyetimit është 16 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 249 i K.Pr.Penale, duke e tejkaluar afatin e arsyetimit vetëm me 6 ditë,

tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm për gjykimin në apel.

- për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 43 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale, pra me e shkurtër se afati 60 ditorë.
- IV. Për çështje të kategorisë *“seancë paraprake”* për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 55 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale, pra më e shkurtër se afati 60 ditorë.
- V. Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”* për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit koha mesatare e arsyetimit është 46 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 pg. 4 i K. Pr. Penale, , pra më i shkurtër se afati 60 ditorë.
- VI. Për çështje të kategorisë *“juridiksion fillestar”*:
- me objekt *“shuarje mase sigurimi sipas nenit 261 të K. Pr. Penale”* koha mesatare e arsyetimit është 12 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 249 i K. Pr. Penale, por duke qenë se afati është tejkualuar me 2 ditë, kjo kategori do të konsiderohet e shqyrtuar brenda afatit ligjor.
 - për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 34 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile, pra më e shkurtër se afati 60 ditorë.

Pra, duke marrë në konsideratë afatin 60 ditorë të arsyetimit të vendimeve penale, sipas parashikimit të nenit 460/1 të KPRP, rezulton se afati i arsyetimit të vendimit është tashmë më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, pra për 6 nga 10 kategori çështjes. Referuar Metodologjisë, kur koha e arsyetimit është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, i korespondon pikëzimit me 12 pikë.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është *“Më e gjatë se afati procedural për të gjithë kategoritë e çështjeve”*, që sipas Metodologjikë se Pikëzimit pikëzohet me 3 pikë, pasur parasysh ngarkesën e lartë në punë të gjyqtarës, e cila gjatë periudhës 1 vjeçare të vlerësimit ka dhënë 469 vendime, kohën e angazhimit të gjyqtarës në seanca gjyqësore si relatore apo si anëtare e trupit gjykues në gjykimet në apel, angazhimit e saj në gjykimet në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e caktuar me vendim të KLGJ, faktin se po të marrim parasysh zgjatjen e afatit të arsyetimit në apel deri në 60 ditë sipas nenit 460/1 të KPRP, afati i arsyetimit të vendimit rezulton më i shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel tjetër pikëzimi, duke i konsideruar afatin e arsyetimit të vendimeve *“Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve”*, që i korespondon pikëzimit me 12 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” të konsiderohet “Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve” dhe pikëzohet me 12 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe raportit analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikatat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore referuar çështjeve të përzgjedhura me short (përrjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse), është **2.4 seanca gjyqësore**.

Numri i seancave gjyqësore sipas kategorive:

- (i) për kategorinë e çështjeve “Penale themeli”, është 5 (pesë) seanca gjyqësore.
- (ii) për kategorinë e çështjeve/kërkesave “Sanca paraprake” - “pushim procedimi penal”, është 2 (dy) seanca gjyqësore.
- (iii) për kategorinë e çështjeve “Civile me palë kundërshtare”, është 1.6 (një presje gjashtë) seanca gjyqësore.

Duhet theksuar se në kategorinë “penale themeli” është përzgjedhur vetëm një çështje.

Po kështu, nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Rezultoni që seancat janë shtyrë për shkaqe shpesh të pavarura nga ana e gjykatës, dhe po kështu seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 14 - 30 ditësh nga njëra - tjetra. Disa nga shkaqet kryesore për të cilën janë shtyrë seancat gjyqësore janë: -

kushtet e paaftësisë shëndetësore të gjyqtarës⁶¹; mosformimit të trupit gjykues⁶²; njoftimit dhe paraqitjes së avokatit të caktuar kryesisht⁶³ apo për t'i dhënë kohë palës të plotësojë të metat e padisë, në kushtet kur është konstatuar se kërkesë padia nuk ishte e shoqëruar me asnjë akt⁶⁴.

Pra në tërësi konstatohet se shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjykatës, por në funksion të shqyrtimit të çështjeve, konform një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë që afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të mos bëhej shkak për cenimin e të drejtave procedurale të palëve në proces.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 2.4 seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e vlerësojnë këtë kriter në shkallë të lartë.

KONKLuzioni

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.4 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “*numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se, përgjithësisht në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në

⁶¹ Vendimi nr. 12, datë 22.01.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁶² Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 dhe Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁶³ Vendimi nr. 30, datë 11.02.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁶⁴ Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët⁶⁵, megjithëse vendimi për caktimin e seancës është titulluar “*Urdhër për veprimet paraprake*”. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi, dhe referuar rregullave procedurale përkatëse për gjykimin në shkallë të parë kur gjykata ka gjykuar çështjen si juridiksion fillestar me objekt kundërshtimin e vendimit të ATP-së sipas ligjit 133/2015. Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa⁶⁶, konstatimi i të metave të kërkesëpadisë⁶⁷, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë*), dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*).

Përgjithësisht seancat kanë filluar në kohë, me vonesa të vogla (*deri në 15 minuta*). Në ato seanca në të cilat procesi ka filluar me vonesë, nga ana e gjykatës është relatuar gjithmonë shkakun, vonesa këto të shkaktuara për shkaqe të pavarura nga ana e gjykatës (qënia e anëtarëve në gjykime të tjera).

Po kështu, evidentohet se seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në procesverbalin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja {...} ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, por pa dhënë shpjegime.

⁶⁵ Neni 460/2/5 i K.Pr.Civile dhe neni 426 i K.Pr.Penale

⁶⁶ Vendimi nr. 87, datë 10.03.2021 dhe Vendimi nr. 318, datë 06.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

⁶⁷ Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet në dosje janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve gjyqësore është e rregullt dhe dokumentet janë lehtësisht të aksesueshme, duke përfshirë aktin e shortit, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik pas çdo seance gjyqësore, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Përgjithësisht, brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Gjyqtarja e ka vlerësuar treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” në shkallë shumë të lartë duke u shprehur si vijon: “Aktet në dosje renditen në mënyrë të rregullt, sipas një rendi kronologjik të veprimeve që janë kryer, në veprime paraprake, seancë përgatitore dhe gjyqësore. Pasi viston nga ana ime, dosja administrohet nga ana e sekretarës gjyqësore dhe dorëzohet në sekretari, duke regjistruar edhe datën e dorëzimit të saj, në një regjistër të posaçëm të mbajtur prej saj, ku nënshkruhet edhe nga punonjësi i kryesekretarisë që e merr në dorëzim.”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit , të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore, mendimi i pakicës në rastet kur gjykata ka vlerësuar ndryshe nga shumica). Përgjithësisht nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Në çështjen e gjykuar si juridiksion fillestar⁶⁸, në dosjen gjyqësore nuk ndodhen provat pasi çështja nuk u gjykua nga Gjykata e Apelit, por është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete.

⁶⁸ Vendimi nr. 195, datë 27.10.2021 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
97	Shkëlqyeshëm

2. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë⁶⁹ rezultojnë se ndaj gjyqtarës {...} në periudhën e vlerësimit viti 2021 rezultojnë se janë depozituar 4 ankesa:

- Ankesa e Z. Ismet Mastaj, ankesë e regjistruar pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me nr. 534 prot., datë 09.06.2021 dhe nr. 535 prot., datë 09.06.2021, përcjellë pranë ILD-së dhe regjistruar me nr. 2781 prot., datë 15.06.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ngre pretendime se gjyqtarja është e

⁶⁹ Shkresat nr. nr. 3348/1 prot., datë 23.12.2022, 1046/1 prot., datë 02.05.2023 dhe nr. 2686/1 prot., datë 25.09.2023

korruptuar, se nuk ka caktuar ekspertë për të zgjidhur çështjen e mbivendosjes së pronave, si dhe se ka qënë në kushtet e pengesës ligjore për të gjykuar çështjen. Në lidhje me pretendimin se gjyqtarja ka qënë në kushtet e pengesës ligjore, evidentohet se vetë ankuesi ka paraqitur një kërkesë përjashtimin e saj, kërkesë e cila është deklaruar e papranueshme nga trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit. Ndërkohë, sa i takon pretendimeve të tjera, është vlerësuar se ato kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural prej gjyqtarës dhe në thelb lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes, e si të tilla janë atribut vetëm i gjykatës më të lartë dhe jo i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Referuar këtij arsytimi, me vendimin nr. 1482/1 prot. datë 24.07.2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Ismet Mastaj.”*

- Ankesa e Z. Geg Peploka, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 2647 prot., datë 07.06.2021 dhe nr. 2467/2 prot., datë 08.06.2021. Pasi është konstatuar se të dy ankesat i përkasin të njëjtit ankues dhe në to pretendohen të njëjtat fakte për të njëjtët magjistratë, me urdhër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur bashkimi i tyre dhe trajtimi i përbashkët. Në themel të pretendimeve të ankuesit, qëndron mosdakordësia e tij me vendimmarrjen, pra me zgjidhjen në themel të çështjes për të cilën ai ka investuar gjykatën. Pas shqyrtimit fillestar, duke vlerësuar se shqyrtimi i vendimmarrjes së gjykatës është atribut vetëm i gjykatës më të lartë dhe jo i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ky i fundit ka marrë vendimin nr. 2647/4 prot. datë 08.07.2021 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara, të paraqitura nga shtetasi z. Geg Pepkolla.”*
- Ankesa e Z. Gjon Biba, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 3967 prot., datë 26.10.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi pretendon se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr. 166, datë 07.06.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk është i bazuar në fakte të vërteta dhe vjen në kundërshtim me praktikën e deritanishme të gjykatës. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, duke vlerësuar se shqyrtimi i vendimmarrjes së gjykatës është atribut vetëm i gjykatës më të lartë dhe jo i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ky i fundit ka marrë vendimin nr. 3967/4 prot. datë 07.01.2022 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Gjon Biba.”*
- Ankesa e Z. Fran Marku dhe Mirela Marku, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 1948 prot., datë 07.04.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesit pretendojnë se vendimi nr. 176, datë 02.10.2020 i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka vendosur për ndryshimin e vendimit nr. 6, datë 30.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është marrë duke kryer shkelje procedurale pasi gjyqtarët kanë qënë të nëjanshëm dhe kanë favorizuar palën kallëzuese. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka arsyetuar se pretendimet për një proces të parregullt ligjor, në shkelje të parimit të paanshmërisë, ankuesit mund të vazhdojnë t'i ndjekin në Gjykatën e Lartë në mbrojtje të interesave të tyre ligjore. Vetëm nëse vendimi i Gjykatës së Apelit cenohet nga gjykata më e lartë për mosrespektim të rëndë/në mënyrë të përsëritur/të gabuar të legjislacionit procedural dhe material, të cilat përbëjnë njëkohësisht edhe

shkelje disiplinore, atëherë ankuesi ka të drejtë të riparaqesë ankesën pranë Zyrës së ILD-së. Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 1948/3 prot. datë 06.05.2021 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së shtetasve z. Fran Marku dhe znj. Mirela Marku.”.

Sikurse rezulton nga shkresat e mësipërme, të gjitha ankesat ndaj gjyqtarës janë arkivuar.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të çenojë etikën e saj në punë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, rezulton se për gjyqtaren {...} janë depozituar 4 ankesa të cilat janë arkivuar.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën 826/26 prot., datë 31.10.2022, rezulton se: Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; Nuk ka kryer fshehje të pasurisë; Nuk ka kryer deklarim të rremë; Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari I gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarës.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivelin shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2021–31.12.2021, janë paraqitur 13 kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, nga të cilat 2 janë pranuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 25 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 22 janë pranuar.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e ka vlerësuar numrin e kërkesave të pranuar për përjashtim si të pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, janë pranuar vetëm 2 nga 13 kërkesat për përjashtimin e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, konstatohet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu evidentohet komunikimi i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk konstatohet që gjyqtarja të ketë ceduar në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ajo është në dijeni për shkak të funksionit.

I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio.

Gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar aftësinë e saj në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjithashtu rezulton se ankesat e depozituara në ILD janë arkivuar të gjitha. Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna që negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë kryetari dhe gjyqtarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se: *“Bashkëpunimi im me personelin e gjykatës është i vazhdueshëm, profesional, praktik dhe konstruktiv, në të mirë të punës. Veçanërisht ky komunikim është i vazhdueshëm me sekretaren gjyqësore, punonjësit e kryesekretarisë, Kancelaren, me nëpunësit përgjegjës për njoftimin e palëve ndërgjyqëse dhe punonjësin IT”*

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2021-31.12.2021, nuk ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në asnjë aktivitet.

Në formularin e vetëvlerësimit është shprehur se: *“Marr pjesë rregullisht dhe angazhohem, me një pjesëmarrje aktive, në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës si dhe në aktivitete të tjera trajnuese jashtë këtij programi, sipas mundësisë, me qëllim ngritjen time profesionale. Kam marrë pjesë jo vetëm si e trajnuar por edhe trajnuese (eksperte) në disa prej seminareve që janë pjesë e programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Prej disa vitesh jam pedagoge e jashtme në Shkollën e Magjistraturës, në lëndën “E drejta familjare”, ku kam trajtuar institute të ndryshme të kësaj fushe si “Përgjegjësia prindërore”, “Kujdestaria”, “Birësimi” etj. Si pasojë e problematilkave të krijuara në Gjykatën e Apelit Shkodër por edhe në gjykatat e tjera të shkollës së dytë, gjatë vitit 2021, jam përfshirë vetëm në procesin e mësimdhënies në fazën e trajnimit fillestar, si pedagoge e jashtme në Shkollën e Magjistraturës, në lëndën “E drejta familjare”, duke zhvilluar 32 orë mësimore. Voumi i lartë i punës së realizuar në në Gjykatën e Apelit Shkodër si dhe çështjet e shyrtuara si gjyqtare e deleguar në Gjykatën e*

Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin e Krimin e Organizuar.”

Ndërkohë, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, pika 3 e nenin 5, parashikohet se;” *Periodha e formimit vazhdues duhet të jetë:*

a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve;
b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.” Pra kjo dispozitë përcakton se gjatë një viti kalendarik, gjyqtari duhet të marrë pjesë në trajnimin vazhdues në jo më pak se 5 ditë trajnimi dhe jo më shumë se 40 ditë në vit.

Në Metodologjinë e Vlerësimit lidhur me këtë tregues përcaktohet se; *Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.*

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet referuar numrit të trajnimeve, kohëzgjatjes tërësore të tyre në raport me një temë të caktuar. Këshilli konsideron vlerë të shtuar për ngritjen profesionale trajnimet afatgjata, përfshirë edhe trajnimet afatshkurtra të specializuara në një fushë të caktuar, të organizuara në periudha kohore të ndërprera.

Ndërsa në lidhje me pikëzimin përcaktohet se; Pikëzimi bëhet sipas tabelës; për periudhën 3 vjeçare, 15-120 ditë trajnimi pikëzohet me 20 pikë dhe më pak se 15 ditë ose më shumë se 120 ditë trajnimi (<15 ose >120 ditë), pikëzohet me 4 pikë.

Kjo nënkupton që për periudhën 1 vjeçare të vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, siç është përcaktuar edhe në ligjin nr.96/2016, periudha e trajnimit vazhdues; 5- 40 ditë trajnimi pikëzohet me 20 pikë dhe më pak se 5 ditë trajnimi ose më shumë se 40 ditë trajnimi në një vit, pikëzohet me 4 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzim maksimal duke pranuar faktin se nuk ka qenë e angazhuar gjatë vitit të vlerësimit në trajnimin vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, por duke pretenduar se kjo ka ndodhur për shkak të ngarkesës tepër të lartë në punë, faktin se në Gjykatën e Apelit Shkodër kanë qenë 3 gjyqtarë, të cilët kanë përballuar një ngarkesë tepër të lartë, faktin se në janar të vitit 2021 është infektuar me Covid-19, faktin se gjatë periudhës së vlerësimit ajo ka qenë pjesëmarrëse në gjykime jashtë gjykatës ku ushtronte detyrën, si pasojë e delegimeve në Gjykatën e Apelit Durrës, apo në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, thujse çdo javë, rrethana të cilat kanë pamundësuar pjesëmarrjen e saj në këto trajnime. Gjithashtu, ajo pretendoi se në rast se asaj do t’i bëhej një vlerësimi i zakonshëm 5 vjeçare, referuar vjetërsisë së saj në punë sipas ligjit, rezulton se ajo e ka plotësuar periudhën minimale të pjesëmarrjes në trajnimin vazhdues, jo vetëm si pjesëmarrëse por edhe si eksperte, duke marrë pjesë vetëm për periudhën 2017—2020 në më shumë se 30 ditë trajnimi.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja nuk ka marrë pjesë në asnjë aktivitet trajnues. Sipas nenit 5 pika 3 e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Metodologjisë së Vlerësimit, për periudhën njëvjeçare, kohëzgjatja duhet të jetë brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit dhe pjesmarrja në aktivitete në më pak se 5 ditë apo në më shumë se 40 ditë gjatë periudhës 1 vjeçare, pikëzohet me 4 pikë. Neni 5 pika 3 e ligjit nr.96/2016 “Për statusin” përcakton se periudha pjesmarrja e magistratëve në formimin vazhdues duhet të jetë jo më pak se 5 ditë në një vit kalendarik. Në kushtet kur nuk ka të dhëna se për pjesmarrjen e gjyqtarës në aktivitete trajnuese gjatë periudhës një vjeçare të vlerësimit, si në rolin e ekspertes/ lehtësueses apo pjesmarrëses, ky tregues duhet të pikëzohet me 4 pikë. Në arritjen e këtij përfundimi u mbajt në konsideratë edhe standardet e vendosura më parë nga Këshilli në vlerësimet e gjyqtarëve të tjerë, të cilët nuk kanë pasur numrin minimal të trajnimeve gjatë periudhës 1 vjeçare të vlerësimit të përshpejtuar të detyruar.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi; Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është jashtë kufijve 5-40 ditë, dhe për këtë arsye pikëzohet me 4 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2021- 31.12.2021 nuk ka marrë pjesë në asnjë aktivitet trajnues në cilësinë e ekspertes apo lehtësueses. Gjithashtum nuk ka të dhëna për angazhimin e saj si udhëheqese për kandidatën për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses apo ekspertes në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magistraturës, apo për angazhimin e saj si udhëheqese e kandidatëve për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtarja {...} ka deklaruar se: *“Kam shfaqur kurdoherë gatishmërinë me qëllim përfshirjen në listat e gjyqtarëve si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe kam propozuar në çdo vit akademik, tema për trajnimin vazhdues.”*

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësues apo ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe nuk rezulton të ketë udhëhequr kandidatën për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtarës dhe për pasojë pikëzohet me 3 pikë

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nuk ka të dhëna për këtë tregues.

Por nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në Raportin Analitik, tek treguesi *“Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”*, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit, 01.01.2021-31.12.2021, gjyqtarja Valbon{...} është miratuar pedagog e jashtme në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021 në lëndën *“E drejtë familjare”* me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 33, datë 22.09.2020 dhe ka dhënë mësim në semestrin e dytë, gjithësej 32 orë mësimore, të zhvilluara në periudhën 26 mars deri në 6 maj 2021.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtarja {...} ka deklaruar se: *“Kur ka qenë e mundur jam angazhuar në veprimtari jashtë funksionit, si mësimdhënie në universitet privat si dhe në çdo vit akademik bashkëpunoj me Shkollën e Magjistraturës si pedagog e jashtme por edhe për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues, përmes propozimit të temave të reja të trajnimeve.”*

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj

se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi rezulton angazhimi i saj në veprimtarinë e mësimdhënies.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera, konkretisht në mësimdhënie pranë Shkollës së Magjistraturës.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: : *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi rezulton angazhimi i saj në këto veprimtari.*

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë publikuar punime akademike.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja nuk ka dhënë shpjegime.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: *Panalizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtarja pikëzohet me 0 pikë, pasi nuk rezulton të ketë publikime ligjore.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit

77	Shumë mirë
----	-------------------

NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	97	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	77	Shumë mirë
Nivelin e përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	374	Shumë mirë

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2021 - 31 DHJETOR 2021

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë	

		3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				97	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë

					11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i	99 %	10	Tej standardit : Nën 81% - 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë

		kryetarit			Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	12	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura	1-3 seanca		Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:

procedural gjqësore	nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				77	Shumë mirë
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të	a. Shkalla e komunikimit dhe	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit:

bashkëpunuar	bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave			E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	<5 ose> 40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	4	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	marrëdhëniet me publikun në gjykata	gjuqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjuqtarit			
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjuqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			374		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shumë mirë		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

